



VENDIM

Nr.65 Datë 27.07.2011

**PËR
MODIFIKIMIN E LICENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “FAVINA” 1 SH.P.K ME SERI PV05P,
NR.29, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE
TË ERE-S NR.85, DATË 27.12.2005**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 13, 14 dhe 15 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /te pjesshem dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.07.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “FAVINA 1” sh.p.k, për modifikimin e licensës Nr.29, Seria PV05P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

Kërkesa e shoqërisë “FAVINA 1” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/te pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Informacioni me shkrim ku shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikim license (Neni 15 pika 4 gërma “a”), është dhënë në mënyrë të detajuar;
- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licensës (Neni 15 pika 4 gërma “b”), është dhënë konform rregullores;

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Modifikimin e licensës Nr.29, Seria PV05P, të shoqërisë “FAVINA 1” sh.p.k, për kryerjen e aktivitetit prodhimit të energjisë elektrike nga HEC – “Vithkuq”.

2. Fuqia e instaluar e HEC – “Vithkuq” nga 2115 kW të bëhet 2715 kW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI